



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E LEGJISLACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot.

Fier, më 24.04.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale pastrimi dhe detergjentë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
**Dorashka 18424000-7, Klor 24311900-6, sapun 33711900-6, letër higjenike 33761000-2,
detergjentë për enë 39831200-8, pastrues dyshemeje 39831300-9, pastrues tualeti
39831600-2**

VLERA E FONDIT LIMIT: prej **4 878 534** (kater milion e teteqind e shtatedhjete e tete e peseqind e tridhjte e kater) **lekë pa TVSH** dhe prej **5 854 241** (pesë milion e teteqind e pesedhejte e kater mije e dyqind e dyzet e nje) **lekë me TVSH**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Fier dhe buxheti i Qendres Ekonomike te Arsimit Fier.

Fondi limit i Qendres Ekonomike te Arsimit Fier eshte **4 377 857** (kater milion e treqind e shtatedhjete e shtate mije e teteqind e pesedhjete e shtate) **leke pa TVSH** dhe **5 253 428** (pese milion e dyqind e pesedhjete e tre mije e katerqind e njezete e tete) **leke me TVSH**, ndersa fondi limit i Bashkise Fier eshte **500 677** (peseqind mije e gjashteqind e shtatedhjete e shtate) **leke pa TVSH** dhe **600 813** (gjashteqind mij e teteqind e trembedhjete) **leke me TVSH**.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (organ qendor bleres) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **1 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën

ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/c të nenit 43 të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kerkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b e nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar; Duke qene se kjo procedure prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale*

vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **700 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

a- vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

ose

b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, te plotësuara sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me pak se **700 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, piken 4 te nenit 40 dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e ketij kriteri

behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine teknike te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet pervojës se meparshme, se zoterojne kapacitet dhe aftesine teknike per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane vendosur bazuar në kërkesën e ardhur nga Qendra Ekonomike e Arsimit me shkresë nr.100 prot., datë 15.02.2023 protokolluar ne Bashkine Fier me nr. 1409 prot date 15.02.2023 dhe ne kerkesen e ardhur nga *Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve dhe Shërbimeve Njerëzore, Marrëdhënieve me Publikun dhe QKB* me nr.3466 prot date 20.04.2023 si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes te Qendres Ekonomike e Arsimit Fier, me urdher nr.11 prot. Date 13/02/2023 percjelle me shkresen nr.100 prot, datë 15.02.2023, dhe nga specilistet e fushes te Bashkise Fier ,me urdher nr.211 dt.19.04.2023 percelle me shkresen nr.3466/1 prot dt, bashkengjitur DST ne SPE .

Specifikimet teknike nuk kane asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, pervec kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e pershkrimit te kerkesave me kusht qe fjala “ose ekuivalent” perfshihet detyrimisht ne keto specifikime.

Shenim : *Ne cdo rast kur ne specifikimet teknike dhe preventive mund te jete perdorur si reference emri i ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , perfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.*

Njësia e Prokurimit: